

VENDIM
Nr.696, datë 14.10.1996

PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË LETRAVE ME VLERË

Në zbatim të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit të Letrave me Vlerë, për vitin 1996, nga fondi kontingjencë i Buxhetit të Shtetit t’i jepen 2 milionë lekë, nga të cilat 1,5 milionë lekë për shpenzime korente dhe 0.5 milionë lekë për investime.

2. Paga mujore e drejtorit ekzekutiv të jetë 30 000 lekë. Për profesionistët teknikë, zyrtarët dhe personelin tjetër administrativ, pagat të caktohen në nivelin e pagave për funksione të ngjashme në ministri dhe institucione të tjera qendrore.

3. Shpërblimi i komisionerëve dhe kryetarit të komisionit të jetë deri në 5000 lekë për çdo mbledhje.

Shpërblimi i anëtarëve të komiteteve dhe kryetarëve të tyre të jetë në 2000 lekë për çdo mbledhje.

Masa e shpërblimit për secilin funksion caktohet nga kryetari i Komisionit të Letrave me Vlerë.

Këto shpërblime jepen sipas kriterëve të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.720, datë 29.11.1995 “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore”.

4. Për kryerjen e funksioneve të veta Komisionit të Letrave me Vlerë i vihen në administratim 4 zyra në ndërtesën e “ish-Komitetit Qendror” kati III, majtas.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi